

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”GJIROKASTER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **Universitetin “Eqrem Çabej”Gjirokaster** me objekt “Mbi zbatimimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko- financiare”, për periudhën 01.01.2010 deri 30.06.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.192 datë 31/12/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 974/13, datë 31/12/2012 dërguar **Z. Gëzim SALA** , Rektor i Universitetit të Gjirokastrës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Për Universitetin e Gjirokastrës” Eqrem Çabej”

1. Nga auditimi rezultoi se në Rregulloren e Administratës “Sektori i Shërbimeve” është në vartësi të “Degës Ekonomike” (neni 16 i rregullores) dhe jo në vartësi të “Drejtorisë së Burimeve Njerëzore”, ku aktualisht funksionon. Gjithashtu rezultoi se, rregullorja e administratës përcakton detyrat që duhet të kryhen për çdo degë, apo sektor dhe jo të specifikuar për çdo vend pune.

Për këtë rekomandoj:

- Nga Universiteti “ Eqrem Çabej” Gjirokastrë të bëhet plotësimi i rregullores sipas funksioneve për çdo vend pune dhe vendosja e strukturave brenda saj, në përputhje me organigramën e miratuar.

Menjëherë

2. Në kundërshtim me pikën 3 të nenit 73 të ligjit nr.7941, datë 21.05.2007 “ Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” në të cilën përcaktohet se: “Institucionet publike të arsimit të lartë bëjnë rregulloret e tyre mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat , duke respektuar rregullat financiare të përcaktuara nga ligjet e shtetit”, *nuk është hartuar dhe miratuar nga Senati dhe Këshilli i Administrimit rregullorja mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat*

Për këtë rekomandoj:

Në përmbushje të detyrimit ligjor, të merren masat përkatëse për miratimin nga Senati dhe Këshilli i Administrimit të rregullores mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Në Universitetin “Eqrem Çabej” nuk ka kontrata pune të konfirmuara si për punonjësit efektiv të miratuar me vendime të Këshillit të Ministrave për çdo vit buxhetor, ashtu dhe kontrata një vjeçare për personelin akademik të punësuar për nevoja të realizimit të programeve mësimore, veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe Statusin e Universitetit “Eqrem Çabej”. **Sa më sipër rekomandoj:**

a - Lidhjen e kontratave për punonjësit efektiv sipas strukturës së miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Afati përfundimit 30 Janar 2012

b - Lidhjen e kontratave një vjeçare për punonjësit e jashtëm mbështetur në orët e mësimdhënies së tyre, referuar programeve mësimore që janë të konfirmuara nga drejtuesit e departamenteve .

Menjëherë

2. Titullari i Universitetit, si autoriteti i ngarkuar me ligj për lidhjen e kontratave të qirave për objekte me sipërfaqe deri në 200 m², t’i propozojë Këshillit Administrativ në fillim të çdo viti buxhetor, numrin e objekteve të lira që ka në dispozicion për t’u lëshuar me qira të tretëve, si autoritet që merr vendimin për miratim sipas kërkesës mbështetur në kap. III, pika 7 të VKM-së nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”,

Menjëherë

3. Të zgjidhet kontrata e qirasë me nr.113, datë 01.3.2012, me objekt dhënie me qira trualli i lirë, e cila është lidhur në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika 6/a, pasi nuk lejohet dhënia me qira e sipërfaqeve të lira deri në 200 m²,

Menjëherë

4. Të merren masa nga Autoriteti Kontraktor, që për hartimin e kontratave në rastet e realizimit të tenderimit “shërbim me roje civile”, të vendoset si kriter detyrimi për monitorim në zbatim të kontratës, në mbështetje të nenit 62 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, pikës 2/b të kreut VIII, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 e ndryshuar si dhe “Rregullores së Administratës” së Universitetit, miratuar me Vendim të Këshillit Administrativ nr. 8, datë 24.11.2011, neni 16/34,

Menjëherë

5. Për të gjithë periudhën objekt auditimi janë paguar punonjës të administratës me orë jashtë kohës normale të punës. Dalja jashtë kohës normale ka funksionuar për të gjithë kohën e sistemit part time dhe për pjesën më të madhe të punonjësve, në maksimumin e orëve të lejuara (limit) të parashikuara nga ligji mbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, veprim që bie në kundërshtim me nenin 85 dhe 87 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

Për këtë rekomandoj:

Të merren masave për organizimin e daljes në punë së punonjësve në ditët e shtuna dhe të diela sipas një grafiku dhe vetëm për ato struktura të domosdoshme, duke kompensuar , ditët e punuara, me ditë pushimi, referuar zbatimit të neneve të mësipërme. Për rastet e mbingarkesave me punë të punonjësve administrativë të parashikohet mundësia e punësimit të punonjësve me kontratë dhe pagesat të realizohen nga të ardhurat sipas parashikimeve në udhëzimin e MASH për përdorimin e të ardhurave.

Menjëherë

6. Në kundërshtim me nenin 75 të ligjit nr. 7941, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.33, datë 10.10.2006 pika c/1 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të arsimit”, nga Universiteti i Gjirokastrës janë miratuar nga strukturat përkatëse të universitetit dhe zbatuar tarifa financiare për realizimin e të ardhurave në shërbimet që kryen institucioni, pa marrë miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrisë së Financave,

Për këtë rekomandoj:

Universiteti i Gjirokastrës të nisë procedurat për miratimin nga institucionet përkatëse të tarifave të shërbimeve, sipas përcaktimit në ligj dhe udhëzimin e mësipërm .

Menjëherë

7. Referuar konstatimit se në UGJ nuk janë mbajtur kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, referuar kufirit maksimal të përcaktuar për pagën mujore, për personelin akademik të jashtëm dhe për personelin akademik të brendshëm, veprim që bie në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1114, datë 30.07.2008 “ Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.05.93 “ Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, **rekomandoj** :

-Të kryhet komunikimi zyrtar me ISSH për mënyrën e procedimit të mbajtjes së kontributeve për pagat që ky institucion realizon për personelin e jashtëm akademik, i cili nuk arrin pagën maksimale në qendrat e punës, ku ky personel është efektiv. Ky komunikim për procedim të mëtejshëm është i domosdoshëm, në kushtet kur aktualisht derdha e këtyre detyrimeve bëhet nëpërmjet sistemit IT(on line), sipas kodeve personale për çdo individ .

Menjëherë

8. Nga auditimi rezultoi se orët e kryera nga stafi akademik për sistemin Part time, nuk janë përfshirë në llogaritjen e orëve të paguara jashtë kohës normale të punës, të cilat janë miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës për të tre vitet 2010, 2011, 6 mujori i parë i vitit 2012, por janë paguar pa miratimin përkatës,veprim që bie në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”,të ndryshuar pika 20 dhe me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 34, datë 29.09.2008 “ Për strukturën e vitit akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë dhe masat që duhen marrë për zbatimin e saj” pika 11,

Për këtë rekomandoj :

- Për çdo rast të pagesave për sistemin Part Time të merret miratimi nga MASH dhe këto orë të futen në sistemin e llogaritjeve të orëve suplementare sipas përcaktimeve në pikën 20 të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 20, datë 09.05.2008 të cituar më sipër.

Menjëherë

9. Nga auditimi i dokumentacionit justifikues të shpenzimit për shërbimet brenda vendit, rezultoi se ky nuk është i plotë në referencë të aktit nënligjor përkatës. Për të gjithë periudhën objekt auditimi mungon autorizimi i titullarit të institucionit që përcakton kohën e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimin e tij, veprim që bie në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 997 , datë 10.12.2010,

Për këtë rekomandoj:

- Nga titullari i institucionit të paraqitet për çdo rast autorizimi, të konfirmohet urdhër shërbimi nga personat udhëtues dhe miratues, dhe për periudhat në vazhdim të bëhet plotësimi i praktikave të dietave si për ato jashtë vendit ashtu dhe për dietat brenda vendit me të gjithë dokumentacionin justifikues të shpenzimit.

Menjëherë

10. Referuar konstatimit se nuk është dokumentuar konsumi i karburantit për kaldajën, duke mos dokumentuar ndezjen e sajë, nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve (çdo ditë dhe monitorimi të konfirmohet me mbajtjen e një proces verbali ditor) si dhe nuk kishte një grafik të miratuar për ndezjen e kaldajës nga strukturat menaxhuese të universitetit, **rekomandoj:**

- Sipas kompetencës së miratimit, nga universiteti duhet të miratohet grafiku kohor i mbajtjes ndezur të kaldajës. Gjithashtu të përcaktohen personat përgjegjës si për funksionimin e saj, ashtu dhe për monitorimin dhe dokumentimin e përdorimit të kaldajës, për rjedhojë matjen e dokumentuar të konsumit të karburantit, si dhe efektshmërinë e sistemit të ngrohjes në institucion.

Menjëherë

11. Referuar konstatimit, se prodhimi i 200 kopjeve për secilin botim të realizuar nga UGJ nuk ka pasur argumentin përkatës dhe nuk është menaxhuar dhe shfrytëzuar në funksion të procesit të mësimnxënies si dhe referuar konstatimit se nga ky institucion nuk u paraqit dokumenti i miratimit nga MASH për botimet e realizuara, **për këtë rekomandoj :**

a. Nga UGJ të rishikohet tirazhi i botimit në analizë të lexueshmërisë së tij, në funksion të programeve të miratuara dhe procesit të mësimnxënies.

b. Në përlllogaritjen e pagesave, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 27.01.1997 “ Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”, të zbatohet indeksi i rritjes së pagës mesatare në shkallë vendi i publikuar nga INSTAT.

c. Të merret miratimi nga MASH për botimet me artikujt shkencore për periudhën në vazhdim të UGJ .

Menjëherë

12. Në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 18.07.2007 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik, të personelit akademik” dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar neni 5, neni 6, janë paguar punonjës akademik për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 pa u pajisur me dokumentin zyrtar diplomë për titullin e fituar, dokument që nuk është i akorduar dhe aktualisht si dhe nuk është regjistruar në “Regjistrin Shtetëror të diplomave dhe çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.

Për këtë rekomandoj:

a. Ndërrprerja e pagesave deri në pajisjen me dokumentin zyrtar “diplomë” për titullin e fituar dhe regjistrimin e këtij dokumenti në “Regjistrin shtetëror të diplomave” në MASH.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të ndiqet në rrugë administrative shpërblimi i dëmit ose në të gjitha shkallët e gjyqësorit për personat personat përgjegjës, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat për rastet e mëposhtme :

a. Shuma si përfitim i padrejtë prej **95,700 lekë** nga Gëzim Sala në shumën 55,200 lekë dhe Vasil Bakuli në shumën 40,500 lekë.

Kjo shumë është përcaktuar si detyrim për kthim, referuar konstatimit se kjo pagesë është jashtë gjykimit të llojeve të pagesave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 27.01.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”.

Menjëherë

b. Shuma si përfitim i pa drejtë nga **16 persona në vlerën prej 773,390 lekë** përfituar si pjesëmarrës në aktivitetin në Qipro si “Dieta për pjesëmarrësit në Qipro” (aktualisht shpenzime transporti) sipas Pasqyrës nr.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kjo shumë është përcaktuar si detyrim referuar konstatimit se dokumentacioni bashkëlidhur urdhër shpenzimit nr. 169, datë 13.07.2009 (në bankën “Raiffeisen Bankë”) në shumën 354,345 lekë dhe urdhër pagesën nr.36, datë 15.07.2009 në shumën prej 419,045 lekë, është dokumentacion jo i mbështetur sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për ruajtjen dokumentimit dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”.

Menjëherë

c. Shuma si përfitim i pa drejtë nga **31 persona në vlerën prej 1,011,300 lekë** përfituar nga kryerja e pagesave për dieta brenda vendit, sipas Pasqyrës nr.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kjo shumë është përcaktuar si detyrim referuar konstatimit, se janë paguar, bazuar në urdhër shpenzimet dhe dokumentacionit bashkëlidhur shpenzimit, dieta për ditët jo zyrtare të punës (të shtuna dhe të diela) në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 997 datë 10.12.2010 pika I.

Menjëherë

d. Shuma si përfitim i pa drejtë nga **39 persona në vlerën prej 12,382,340 lekë** dhe shuma për **3 persona në vlerën 387,737 lekë** përfituar nga kryerja e pagesave për titull shkencor të akorduar pa mbaruar procesi i diplomimit, sipas Pasqyrës nr.3 dhe 3/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kjo shumë është përcaktuar si detyrim referuar konstatimit se në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 18.07.2007 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik , të personelit akademik” si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “ Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar neni 5, neni 6, janë paguar punonjës akademik për vitet 2009, 2010,2011,2012 pa u pajisur me dokumentin zyrtar diplomë për titullin e fituar, dokument që nuk është i akorduar dhe nuk është i regjistruar në Regjistrin Shtetëror të diplomave në MASH për 39 punonjësit akademik.

Menjëherë

e. Shuma si përfitim në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi i 19,731 orëve **në vlerën gjithsej prej 18,817,746 lekë** nga punonjësit akademik për kohë jashtë kohës normale të punës për funksione administrative, ku përfitimi sipas viteve objekt auditimi është :

- **Për vitin 2010** janë paguar 27 punonjës akademik për shumën totale 6,281 orë **dhe vleftën 6.013.917 lekë.**

- **Për vitin 2011** janë paguar 24 punonjës akademik për shumën totale 8,360 orë **dhe vleftën 7,876,635 lekë.**

- **Për 6 mujorin e parë të vitit 2012** janë paguar 26 punonjës akademik për shumën totale 5,090 orë **dhe vleftën 4,927,194 lekë,** sipas Pasqyrave nr.4, nr.5 dhe nr.6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kjo shumë është përcaktuar si detyrim, referuar konstatimit se këto pagesa janë kryer në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.06.2009 “ Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve akademik të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, neni 10,

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në nenin 20 e 21 të “ Rregullores së Etikës” të Universitetit “ Eqrem Çabej” të miratuar në zbatim të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “ Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Statusit të Universitetit“ dhe “Rregullores së Brendshme” në fuqi, i propozojmë “Këshillit të Etikës” të Universitetit, dhënien e masave disiplinore :

a. “ Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” neni 20, pika 2, germa b për [REDAKTUAR] me detyrë kryetare e “ Degës Ekonomike”:

- për mos zbatim të vendimit të KM nr. 228, datë 13.04.2001 dhe vendimin e KM nr. 997, datë 10.12.2010 pasi ka paguar punonjësit e institucionit për dietat brenda vendit për ditët jo zyrtare të punës.

- për mos zbatim të vendimit të KM nr. 748, datë 11.06.2009, të ndryshuar, pasi ka paguar për orët jashtë kohës normale të punës punonjësit akademik të Universitetit në kundërshtim me neni 10 të vendimit të KM .

(Mbajtur procesverbal nr. 6, datë 11.10.2012)

- për kryerje pagesash (shpenzime transporti për dieta jashtë vendit) pa dokumentacionin e domosdoshëm justifikues në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984 “ Për ruajtjen dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”. (Mbajtur procesverbal nr. 8, datë 17.10.2012)

- për miratim të shpenzimeve kur dokumentacioni bashkëlidhur shpenzimit është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik

b. “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, neni 20, pika 2, gërma b për z. [REDAKTUAR] me detyrë Kancelar për shkeljet dhe mangësitë e rezultuara në material dhe për të cilat janë mbajtur procesverbalet përkatëse.

Aktualisht [REDAKTUAR] me detyrë “ Kancelar” për periudhën objekt auditimi ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me këtë institucion (është larguar me dëshirën e tij) prandaj këtë masë disiplinore **nuk ja propozojmë** “ Këshillit të Etikës “ pasi ajo është ezauruar me largimin e tij nga ky institucion..

c. “Vërejtje me shkrim” neni 21, pika 2, germa a për [REDAKTUAR] me detyrë “shefe e financës”:

- për mos zbatim të vendimit të KM nr. 228, datë 13.04.2001 dhe vendimin e KM nr. 997, datë 10.12.2010 pasi ka paguar punonjësit e institucionit për dietat brenda vendit për ditët jo zyrtare të punës (Mbajtur procesverbal nr. 2, datë 10.10.2012)

- për mos zbatim të vendimit të KM nr. 748, datë 11.06.2009, të ndryshuar, pasi ka paguar për orët jashtë kohës normale të punës punonjësit akademik të Universitetit në kundërshtim me neni 10 të vendimit të KM .

e. “Vërejtje me shkrim”, neni 21, pika 2, germa a për [REDAKTUAR] me detyrë “ Përgjegjësi i sektorit të shërbimeve”:

- për mos monitorim referuar rregullave që duhej të zbatoheshin për funksionimin e kaldajës si dhe mos dokumentimin real, hap pas hapi, të konsumit të karburantit të harxhuar nga kaldaja.

Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

I. A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit nga auditimi i kryer në Universitetin “ Eqrem Çabej” në Gjirokastër konstatoi se nuk interpretohen drejt dhe për rrjedhojë nuk zbatohen me korrektësi udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës mbi realizimin e kohës së punës për punonjësit akademik kryesisht për kohën e orëve suplementare duke përfshirë në këto orë, orët part-time që duhen të miratohen për tu paguar, referuar akteve në fuqi.

Gjithashtu është konstatuar se nga stafi akademik janë kryer dhe paguar një numër shumë i madh orësh suplementare të cilat kanë qenë pjesë e miratimeve ose jo nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe që kanë tejkaluar në përqindje të lartë normën e mësimdhënies vjetore për çdo kategori të punonjësve akademik,

Referuar këtyre konstatimeve për eliminimin e interpretimeve “ndryshe” **i rekomandoj** Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përmirësimin e Udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, duke ngritur grup pune dhe rishikuar këtë udhëzim në drejtimet e më poshtme:

- Përcaktimin e nivelit maksimal të orëve suplementare që mund të paguhet personeli akademik efektiv në IAL, referuar orëve të mësimdhënies vjetore të normuar. Ky përcaktim të bëhet i veçantë për stafet akademike me funksione drejtuese.
- Përcaktimin në mënyrë specifike që orët part time duhet të jenë pjesë e kufirit të përcaktuar të mësipërm.
- Rishikimin e kufijve të mësimdhënies së normuar vjetore për çdo kategori personeli akademik .

B. MASA ORGANIZATIVE

I. Mbështetur në faktin se Universiteti “Eqrem Çabej” është institucion i vartësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës , referuar kompetencave të përcaktuara në ligjin nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” , mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit midis KLSH dhe Ministrisë së Financave, nënshkruar në datën 8.05.2012, në të cilën një nga pikat e bashkëpunimit është zbatimi i Standardit 9150 të INTOSAI:“Koordinimi dhe Bashkëpunimi mes Institucioneve të Auditimit Suprem dhe Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik”, **rekomandojmë** :

- Struktura e Auditimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të analizojë, programojë dhe auditojë zbatimin e rekomandimeve të lëna për zbatim nga KLSH në subjektin e audituar Universiteti “Eqrem Çabej”, duke informuar zyrtarisht KLSH.

II. Për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e fondeve buxhetore të Universitetit “Eqrem Çabej” (financim nga buxheti dhe të ardhurat e realizuara nga institucioni), për të cilat janë nxjerrë përgjegjësitë dhe ku një pjesë e të cilave i është adresuar Rektorit të universitetit z. [REDAKTUAR] , **të informohet Ministri i Arsimit dhe Shkencës**, për shkeljet sa më poshtë vijon:

- Për urdhërimin e pagesave në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 18.07.2007 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik , të personelit akademik” si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar ku janë paguar punonjës akademik për vitet 2009, 2010,2011,2012 pa u pajisur me dokumentin zyrtar diplomë për titullin e fituar dokument që nuk është i akorduar dhe aktualisht për 39 punonjësit akademik. Gjithashtu për këto punonjës nuk është bërë regjistrimi në regjistrin shtetëror të diplomave. Këto punonjës janë paguar vetëm mbi bazën e vendimit të këshillit të profesorëve. (Mbajtur akti nr. 3 datë 11.10. 2012)

- Për lidhje të kontratave me të tretë për dhënie trualli të lirë në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika 6/a .
- Për urdhërimin e pagesave për stafin akademik për orët e realizuara në sistemin e mësimdhënies Part time, pa i përfshirë këto orë në llogaritjen e orëve të paguara jashtë kohës normale të punës, për të cilat duhet të merrej miratimi nga MASH, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.20, datë 09.05.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar pika 20 dhe me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.34, datë 29.09.2008 “ Për strukturën e vitit akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë dhe masat që duhen marrë për zbatimin e saj” pika 11.
- Për Urdhërimin e pagesave për shpenzime transporti për jashtë shtetit (grup pedagogësh dhe studentësh në Universitetin e Qipros me ftesë jo origjinale dhe kur këto shpenzime referuar një marrëveshje të mëvonshme rezulton se ishin përballuar nga pala ftuese, dhe ku vetë Rektori ka qenë pjesë e grupit .
- Për përcaktimin e tirazhit të botimeve për artikujt shkencorë me vendimet e organeve përkatëse, por pa argumentimin e këtij tirazhi dhe pa monitoruar përdorimin dhe shpërndarjen e këtyre botimeve për nevoja të studimit.
- Për urdhërimin e kryerjes së shpenzimit me fondet e institucionit për prodhimin e një Albumi dhe DVD me rastin e festës së 15 vjetorit të Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek, ku këto materiale janë pranuar me përmbajtje reklame të AMC dhe që mbas këtij konstatimi nuk ka vepruar dhe reaguar për të analizuar shkaqet e këtij veprimi si dhe kërkimin e kompensimit të demit, pasi urdhër shpenzimi është paguar me fondet buxhetore.

Për Agjencinë e Prokurimit Publik

A. MASA ADMINISTRATIVE

1. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 7, pika 2, 3/a, **i rekomandoj Agjencisë së Prokurimit Publik, që:** Në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, të vendosë “gjobë” në masën 50,000 lekë për [REDAKTUAR], ish-jurist në NJP, pasi:
 - në administrimin e dosjeve të tenderëve të zhvilluar për vitet 2010, 2011 dhe 6 mujori I vitit 2012, kishte mungesa të theksuara në dokumentacionin fizik dhe inventari nuk ishte bërë konform kërkesave nenit 12, pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar si dhe Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”,
 - në të gjitha dosjet e tenderëve mungonte procesverbali i miratimit të dokumenteve standarde të tenderit (DST), veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 të ndryshuar, kreu V, pika 2/a,b , si dhe me Manualin e prokurimit publik “Udhëzuesit e procedurave të prokurimit publik” pika 2.3, dhe 2.5.

- mungonin kopje të botimit në Buletinin e Njoftimeve të APP mbi shpalljen e tenderit dhe fituesin, në kundërshtim me Manualin e prokurimit publik, pika 3.1” Njoftimi kontratës”.

B. MASA DISIPLINORE

1. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar dhe ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 7, pika 2, 3/a, **i rekomandoj Agjencisë së Prokurimit Publik, që:** në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, t’i propozojë Autoritetit Kontraktor, Universiteti “Eqrem CABEJ” Gjirokastër, marrjen e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim” për anëtarët e Njesisë së Prokurimit :

1. [REDACTED]
2. [REDACTED]
3. [REDACTED]
4. [REDACTED]

Pasi nuk kanë mbikëqyrur në mënyrë të vazhdueshme mbledhjen e të të gjitha materialeve të nevojshme që i bashkëngjiten dokumenteve të tenderit, nuk kanë mbajtur gjatë procesit të hartimit të dokumenteve standarde të tenderit për të gjitha procedurat e zhvilluara procesverbalin përkatës për miratimin e tyre duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, date 10.01.2007 e ndryshuar, kreu V, pika 2/a,b , si dhe me Manualin e prokurimit publik “Udhëzuesit e procedurave të prokurimit publik” pika 2.3, dhe 2,5.

Shënim :

- Për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave [REDACTED], meqenëse i kemi kërkuar “ Këshillit të Etikës” së Universitetit dhënie e masave disiplinore në nivel më të lartë se sa propozimi i mësipërm “ **Vërejtje me paralajmërim**”, jemi të mendimit që të mos i propozojmë APP –së për dhënie mase këtyre dy punonjësve.

- Për [REDACTED], në cilësinë e Kryetarit të KVO meqenëse ka ndërprerë marrëdhëniet financiare me këtë subjekt (është larguar me dëshirën e tij), nuk propozojmë masa disiplinore pasi ajo është ezauruar me largimin e tij nga ky institucion.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Nikoleta Piranian,Dritan Kore dhe Miranda Haxhia. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit znj.Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z.Ded Trieshi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z.Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

[Shqiptaria.com]